



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjeve:
 - “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”,
 - “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”
 - “Për një shtesë në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Reme Lala, Xhevit Bushaj dhe Ilir Beqja.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Roland Xhelilaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Agron Shehaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makro-ekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse sektori

Alba Çaroshi – Këshilltare

Arbër Lleshi – Këshilltar

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Fillojmë mbledhjen normale të Komisionit të Ekonomisë dhe të Financave.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin nën për nën dhe në tërësi të projektligjeve: “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, si dhe “Për një shtesë në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Fillojmë menjëherë me ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Zoti Ministër, meqenëse mbledhjet e mëparshme kanë qenë në kushte tërësisht anormale, a mund të na thoni shkurtimisht cilat janë pikat kyçe të këtij projektligji për të cilat qeveria ka vendosur? Pra, qytetarët duhet të dëgjojnë atë që s’kanë pasur mundësi ta dëgjojnë gjatë këtyre tri ditëve të mëparshme për shkak të zhurmës dhe rrugaçerisë marramendëse në këtë komision.

Arben Ahmetaj - I detyruar edhe nga ato zhvillime që pamë në komision para disa ditësh, unë po kaloj shumë shpejt risitë e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Ajo që është më kryesorja është se ka një lëvizje fiskale shumë të rëndësishme për të lehtësuar bazën fiskale kryesisht mbi biznesin e vogël në vazhden e asaj iniciative të dikurshme ku taksa zero mbi biznesin e vogël për qarkullimin nga zero deri në 5 milionë dhe nga 5-8, 5%. Gjatë diskutimeve që patëm me biznesin e vogël dhe jo vetëm, në periudhën kur u ul edhe dyshemeja e detyrimit për deklarimin për tatimin mbi vlerën e shtuar, nga 5 në 2 milionë, doli si domosdoshmëri, më duhet ta them, madje edhe si pozitivitet nga vetë sipërmarrja e vogël, ngritja e tavanit të xhiros nga 8 diku në 10 milionë.

Në një analizë që ne bëmë me porosi të Kryeministrit dhe me shtytje të kryetarit të këtij komisioni dolëm në konkluzion që do të ishte me rëndësi dhe me vlerë edhe për procesin e antiinformalitet që ne kemi ndërmarrë të rrisim tavanin nga 8 milionë në 14 milionë, duke lehtësuar kështu për shumë biznese barrën fiskale nga 15% tatim fitimin në 5%, pra tri herë më pak. Me këtë lëvizje që po i referohem ne praktikisht kemi 91% të bizneseve me tatim fitimi ose zero ose 5%. Kjo është historike që në ekonominë e një vendi 91% e bizneseve të kenë tatim fitimin ngarkesë zero ose 5%. Ne besojmë se kjo jo vetëm është lehtësim, por do të jetë një ndihmë shumë e madhe për formalizimin e ekonomisë.

Lëvizja tjetër, që është shumë e rëndësishme, ka të bëjë me një sektor shumë të rëndësishëm që është agroturizmi. Ky komision i nderuar ka qenë në debat për lehtësimin që i kemi bërë me paketë të rëndësishme në vjeshtë të vitit të kaluar turizmit për strukturat akomoduese 4 dhe 5 yje, atë ditë, nëse i referohemi, së bashku premtuam se do të vinim me një lehtësi fiskale edhe për agroturizmin. Sot, praktikisht, kemi ardhur me një propozim për të ulur tatim-fitimin edhe për agroturizmin duke iu referuar, në mos gabohem, vendimit 22 të KM-së, ku ka definuar agroturizmin si aktivitet tregtar me ato kufizimet dhe përkufizimet e veta, e ulëm tatim-fitimin nga 15 në 5%.

E treta, që është po kaq e rëndësishme, ka të bëjë me sektorin e bujqësisë. Pra, ne kemi diskutuar shumë shpesh se cilat janë problemet e këtij sektori dhe cila është arsyeja që sektori i bujqësisë akoma ka atë strukturë ekonomike dhe një nga konkluzionet që kemi nxjerrë së bashku ka qenë që struktura fiskale duhet të jetë ndihmuese për të kaluar në integrim, pra në një ekonomi shkalle edhe në bujqësi. Ne kemi marrë iniciativën e dytë lehtësuese për sa i përket sektorit të bujqësisë, e para ka qenë për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, njohja e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor si një fermer i vetëm i mban për të përfituar rimbursimin e TVSH-së dhe për të mos u futur në procesin e deklarimit, pra, heqjen e tavanit prej 5 milionë për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, tani po vijnë edhe me lehtësinë tjetër fiskale, ku për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor ulet tatim-fitimi nga 15% në 5%.

Ka qenë edhe një debat me ju, një kërkesë e drejtpërdrejtë e kryetarit të komisionit, kështu që besoj se me këtë paketë të re për uljen e tatim-fitimit kemi krijuar një lehtësim të konsiderueshëm fiskal, po jo thjesht lehtësim fiskal, por edhe një ndihmesë nëpërmjet instrumenteve fiskale për strukturim më të mirë të sektorëve, si ai që iu referova për sa i përket bujqësisë.

Pra, këto ishin pak a shumë. Ka disa korrektime të thjeshta brenda. Dua t'ju bëj me dije ju kryetar dhe anëtarë të komisionit se kemi shkëmbyer më njëri-tjetrin një shqetësim, i cili në këndvështrimin tonë të përbashkët mund të ketë qenë edhe paradoks, por ne do ta korrigjojmë së bashku sot. Ne kemi sjellë edhe propozimin në bazë të atij debati që patëm, ku i referohem konkretisht transaksionit në bujqësi të tokës. Imagjinoni kemi një paradoks që kur ka shitje të tokës bujqësore, nuk ka taksim të transaksionit, kur ka zbritje nga certifikata e pronësisë për ato prona të marra në bazë të ligjit nr.7501, të ndryshuar, ndërkohë që kalon nga babai te fëmija, në bazë të logjikës aktuale të taksimit do të duhet të taksohen si transaksione. Duhet të vejmë një barazim midis transaksionit brenda familjes, i cili nuk është transaksion tradicional dhe transaksionit tradicional që nuk tatohet.

Të dyja pra, nuk do të tatohen.

Kemi sjellë edhe një sensibilitet, sepse ditën që ka dalë ligji 7501 ka pasur fëmijë që kanë qenë 3-5 vjeç, pra pa certifikatë, sot ata meritojnë në bazë të ligjit pjesë të pronës, pra kemi futur edhe konceptin brenda të njëjtës kategori, të dhurimit jo vetëm të kalimit të pronësisë. Kjo zgjidh një herë e mirë këtë ngërç që ka qenë në vazhdimësi i referuar edhe nga terreni ekonomik.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Ministër!

Mua nuk më ngelet gjë tjetër të them se gjithë çka kemi diskutuar edhe më paketën e mëparshme fiskale, të lëna si detyra edhe për qeverinë, tashmë janë materializuar plotësisht dhe dua të falënderoj gjithë kolegët që janë përfshirë në këto ndryshime të rëndësishme, ashtu siç dua të falënderoj edhe qeverinë që ka dëgjuar, ka analizuar, ka reflektuar dhe në fund ka vendosur.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është kundër? Nuk ka.

Kush është pro?

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Fillojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Do të duhet të shtojmë këtë që sapa ju thatë për transaksionet brenda familjes.

Atëherë propozimi është ky: “Të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër apo një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor, përjashtohen nga tatimi. Gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore, burrë, grua, fëmijë nëpërmjet dhurimit ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit 7501, datë 19.07.1991”, të ndryshuar”, përjashtohen nga tatimi.

Pra, për ta sqaruar për të gjithë ata që na ndjekin, kryesisht të gjithë banorët e zonave rurale, në vitin 1991, kur toka u nda, është ndarë për frymë dhe sasia e tokës i është kaluar secilit prej anëtarëve të familjes, tani që fëmijët janë rritur, janë ndarë nga trugu familjar, kanë krijuar familje të tyre, duan të marrin edhe tokën nga certifikata familjare në certifikatë personale të familjes së re që kanë krijuar.

Deri tani për këtë transaksion është paguar 15% e vlerës së tokës sipas sistemit të referimit të aplikuar për vlerën e tokës.

Që nga ky moment ne shkojmë drejtë tatimit zero lekë edhe për këtë gjë. Kjo është ajo që bëjmë.

Atëherë, ky nen merr numrin 1 në projektligj. Ndryshimi bëhet te neni 8/1, pika 11, paragrafi i parë i ligjit ekzistues.

Ju ftoj ta votojmë!

Kush është kundër? Nuk ka.

Kush është pro?

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet ky ndryshim dhe bëhet neni 1.

Neni 1, që do të bëhet neni 2 i projektligjit.

Pika 1 e nenit 11, ndryshohet si më poshtë vijon: “Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore tatohet me normën 15%. Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi në bazë të një kontrate shkëmbimi nuk përbën moment për llogaritjen e ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme”. Kjo është një kërkesë e ardhur edhe nga shoqatat e biznesit, materializuar më herët në ligjin tjetër respektiv dhe natyrisht edhe reflektuar në këtë nen.

A ka ndonjë shqetësim për këtë nen?

Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votimin e nenit 1, që bëhet neni 2.

Kush është kundër? Nuk ka.

Kush është pro?

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Paragrafët 3 dhe 4 të nenit 20 shfuqizohen.

Urdhëroni, zonja Gjylameti si relatore!

Blerina Gjylameti – Vazhdoni zoti kryetar, meqenëse i keni të gjitha vërejtjet.

Faleminderit!

Erion Braçe - A ka ndonjë vërejtje për nenin 2 që bëhet neni 3? Nuk ka.

Kush është kundër? Nuk ka.

Kush është pro?

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 që bëhet neni 4.

Në nenin 28 shkalla tatimore bën ndryshimet e mëposhtme:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon: “Shkalla e tatimit mbi fitimin është 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 milionë lekë në vit, 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 milionë lekë në vit. Pra, dua të sqaroj edhe një herë për të gjithë ata që na ndjekin, qytetarë, sipërmarrës, të rinj apo të moshuar, që merren me këtë aktivitet, që për xhiron e tyre deri në 14 milionë lekë të reja në vit tatimi bie nga 15% në 5%, pra ulet 3 herë.

Pika 2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 dhe 4 me këtë përmbajtje: “Personat juridikë të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr.38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, e kanë shkallën e tatimit mbi fitimin 5%. Pra, për të gjithë shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe blegtoral në të gjithë territorin e vendit tatimi mbi fitimin zbritet në 5%.

Pika 4: “Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari agroturistike të certifikuar si agroturizëm, bazuar në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin” dhe vendimin e KM-së që miraton kriteret për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%”.

Norma e reduktuar e tatimit mbi fitimin 5% e parashikuar sipas këtij paragrafi aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë statusin “Subjekt i certifikuar agroturizmi” deri në vitin 2021.

Efektet e normës së reduktuar fillojnë në vitin pasardhës, pas përfitimit të statusit “Subjekt i certifikuar agroturizmi”.

Zoti Beqaj ka kërkuar fjalën.

Ilir Beqaj - Faleminderit!

Në fakt, ndjesë nëse po kthehem te neni 1, se dua të ndaj me ju këto meditime. Është e vërtetë se ka qenë një problem real moszhvillimi i bujqësisë si pasojë e mospajisjes me tituj pronësie, aq më shumë që nga viti '91 deri sot kanë kaluar shumë vjet.

Besoj se ajo që miratuam sot është pozitive, por unë kam një rezervë shumë të madhe, sepse problemi themelor që ka bujqësia këto 25 vjet është konsolidimi i tokës. Ne pronat i kemi mesatarisht 1.2 hektarë dhe kështu do të vazhdojmë t'i copëzojmë.

Dua t'ju sjell në vëmendje se legjislacioni shqiptar i para Luftës së Dytë Botërore, legjislacionet e vendeve të BE-së sot e kanë zgjidhur në Kodin Civil prej 3 shekujsh që tokën e trashëgon fëmija më i madh, burrë, përndryshe djali i vajzës më të madhe, burrë dhe pastaj babai, midis vëllezërve dhe motrave, fëmijët e tij e zgjidh ndryshe çështjen. Do ta zgjidhim ndoshta për 5 vjet, por do të vijë dita që do të na bëhet problem, sepse ne e kemi sot fermën të vogël. Unë e kam këtë shqetësim.

Shqetësimi i dytë, ndoshta mund të më sqarojë ministri se nuk jam shumë i qartë, personi juridik sh.p.k. mund të ketë një xhiro 30 milionë të reja dhe do të tatohet 5%. Personi juridik sh.p.k. me një ortak të vetëm do të tatohet 15%, në qoftë se merret po me bujqësi. A nuk krijojmë arbitrazh fiskal?

Arben Ahmetaj – Besoj se krijove një kundërshti të asaj që the në fillim, agregimin e tokës apo të faktorëve të punës, po themi.

Çfarë jemi duke bërë me këtë lehtësim?

Jemi duke shtyrë fermerët të bashkohen në kooperativa në prodhim, por automatikisht edhe në shitje...

Erion Braçe – Më falni, nëse me lejoni t'ju ndërpres. Kemi një përpjekje 27- vjeçare për t'i bashkuar fermerët me pronën, nuk bashkohen. Atëherë, duam të ofrojmë një mundësi për t'i bashkuar në prodhim dhe në shitje.

Arben Ahmetaj - Çfarë jemi duke bërë nëpërmjet kësaj? Jemi duke dalluar korporatën në bujqësi me Shoqatën e Bashkëpunimit Bujqësor në bujqësi. Ajo që iu referuat ju, nëse është me 30 milionë lekë të rinj, me 300 milionë, apo me 3 miliardë lekë të rinj, është koncepti i korporatës së bujqësisë. Ne po kapim embrionin me këtë lëvizje fiskale, po marrim fermerin dhe po e incentivojmë për t'u bashkuar në kooperativa, jo varianti sovjetik, por varianti i ekonomisë në një shkallë ku fitueshmëria dhe produktiviteti bëhet më i madh, duke luftuar atë që ne mendojmë se është problemi: toka është e copëzuar në 1-2 dynym. Unë nuk mendoj se jemi duke krijuar një problem, absolutisht, jo! Ne po incentivojmë që fermerët të shikojnë leverdishmërinë e të bashkuarit të gjithë faktorëve të punës. Besoj se korsa e korporatizimit në bujqësi është një element, i cili vazhdon normalitetin e tij. Këtu kooperativa është edhe luftë kundër një kulture ose më mirë luftë ndaj një antikulture, se frika e të bashkuarit bashkë është e trashëguar për shkak të reminishencave. Tani nëpërmjet dy lëvizjeve fiskale besoj se krijojmë një platformë, nuk po them se kemi krijuar optimalen, por besoj se kemi injektuar disa incentiva që kanë mundësi ta çojnë në atë drejtim bujqësinë.

Ilir Beqaj - Kam një koment të fundit. Shikoj riskun, të kesh 30 milionë të ardhura, do të thotë që të kesh një aktivitet në bujqësi të paktën mbi 10 hektarë. Mund të nxisim një proces të kundërt që për arsye të 5%- it ta copëzojë, meqenëse edhe sot copëzimi ju taksohet si pronë, 0 % për të shkuar në 5%.

Arben Ahmetaj - Ju thoni se x subjekt do t'ia shesë fermerit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ndodh kjo. Jemi duke folur për fermerët aktualë, të cilët jo aty ku është agreguar dhe integruar toka, por aty ku ligji nr. 7501 ka lënë ngastra të vogla. Pra, ka një diferencë shumë të madhe në strukturë.

Erion Braçe - Te pika 2 e këtij neni kemi një riformulim apo jo, që i referohet pikës 4?

Pra “Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit. Shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin e “subjektit të certifikuar të agroturizmit” deri më dhjetor të vitit 2021”, thoni ju.

Arben Ahmetaj - Deri më 31 dhjetor.

Erion Braçe- “Efekti, aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës pas përfitimit të statusit “subjekt i certifikuar i agroturizmit”. Ky është ndryshimi?

Arben Ahmetaj - Po, vetëm 31 dhjetori për saktësim.

Erion Braçe - Kam një pyetje, pse duhet ta fiksojmë deri në vitin 2021, ndërkohë që të tjerëve u kemi lënë afat deri në vitin 2024?

Arben Ahmetaj - Janë 2 nënsektorë brenda të njëjtin sektor shumë të ndryshëm, agroturizmi do shumë pak investim, e ka xhiron e produktivitetit shumë më të shpejtë, aty jemi duke folur për nivel tjetër turizmi dhe është shëndetshmëri fiskale që të promovohet nëpërmjet instrumentit fiskal, por është edhe shëndetshmëri fiskale për t’ia kufizuar këtë dritare.

Erion Braçe - Zoti ministër, kam vetëm merakun se është kohë shumë e shkurtër. Ju po e shikoni se Kryeministri e ka ndier vetë kudo ku ka lëvizur, po insiston dhe thotë: “Aplikoni për agroturizëm”, është e vështirë t’i bindësh njerëzit të hyjnë në një veprimtari të re ku do të fusin edhe paratë e tyre dhe do të bëhen bashkëfinancues bashkë me shtetin dhe të tjera me radhë. Kam frikë se është kohë e shkurtër.

Arben Ahmetaj - Besoj se duke iu referuar edhe shqetësimit tuaj, nuk është kështu, sepse nuk është 5%-shi i tatim fitimit që i jep mundësinë të futet në sektor, por është fitueshmëria...

Erion Braçe - Jo, nuk po flas për këtë. Kjo është 10-vjeçare.

Arben Ahmetaj - Koha e aplikimit nuk ka lidhje fare me produktivitetin dhe me mundësinë. Mundësia është 3 -vjeçare për të përfituar lehtësi 10 -vjeçare. 3 -vjeçare është e mjaftueshme. Ne duam ta shikojmë këtë zhvillim të shpejtë. Ky element është ndihmues, sepse sado të bëhen lehtësira fiskale në një sektor, i cili nuk ka produktivitet dhe

fitueshmëri nuk ndodh gjë. Ky është në vetvete sektor me fitueshmëri dhe produktivitet shumë të mirë, të lartë. Besoj se 3 vjet janë të mjaftueshëm për të pasur të paktën 100-120 mundësi agroturizmi në Republikën e Shqipërisë.

Erion Braçe - Zoti Ministër, e di se çfarë kam merak? Disa rajone të vendit janë të lidhura ngushtësisht edhe me infrastrukturën, e cila ka filluar tani të zhvillohet dhe do kohën e saj të maturimit. Kam parasysh të gjithë zonën nga Lindja e Dajtit deri në Dibër për shkak të Rrugës së Arbrit që hapet një rajon fantastik për agroturizmin. Kam parasysh të gjithë zonën nga Kardhiqi deri në Delvinë, që përsëri është nën regjim investimi pikërisht tani që hapet, kam parasysh zonën malore të Tepelenës dhe të tjera me radhë.

Arben Ahmetaj - Nuk ka lidhje me këtë.

Zoti kryetar, e kuptova shumë mirë...

Erion Braçe - Zhvillimi i kësaj infrastrukture do të hapë mundësi për ato rajone për këtë gjë. Do t'u japim një mundësi që këta bashkë me kohën e maturimit të infrastrukturës...

Arben Ahmetaj- Zoti kryetar, ne besojmë se 3 vjet është e mjaftueshme. Në fakt 3 vjet e gjysmë, sepse vendimi nr.22 ka të paktën 4 muaj, që ka dalë, që në muajin janar. Pra, u bënë 4 vjet mundësi.

Erion Braçe – Në rregull. Atëherë biem dakord kështu siç është riformuluar? E hedhim në votim nenin 3 që bëhet neni 4. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 që bëhet neni 5.

Neni 4 lidhet me nenin 33/1 “Depozitimi i vendimeve për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit bën ndryshimet si më poshtë vijon: “ Në pikën 2 hiqen fjalët “dhe personat fizikë, vendimin e personit fizik, si dhe për çdo muaj vonesë”.

Në pikën 4 hiqen fjalët “vendimi i personit fizik”. A ka ndonjë vërejtje lidhur me këtë nen? Nuk ka. E hedhim në votim nenin 4 që numërohet neni 5. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 që numërohet neni 6.

Paragrafi i dytë i pikës 7 të nenit 38 “Dispozitat kalimtare” ndryshohet si më poshtë vijon: “ Tatimi për lojërat e fatit sipas nenit 52/2 të ligjit nr.155/2015 “ Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” aplikohet në shkallën 15% mbi të ardhurat bruto nga lojërat për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të

licencuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Zoti Angjeli, urdhëroni!

Anastas Angjeli - Kam dy pyetje, por para se t’i bëj kam një vlerësim. Ky nen ka një anë pozitive, sjell një saktësim të përcaktimit të të ardhurave bruto në krahasim me dispozitën kalimtare që e kishim vënë herën e kaluar. Besoj se ky është thelbi i këtij neni, megjithëse në fillim të fjalës vetë tatimi ndoshta duhet të përcaktohet se çfarë lloj tatimi është. Në fund të fundit tatimi mbi fitimin llogaritet sipas kësaj. Për cilin tatim bëni fjalë? Fillon fjalja: “Tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat”, shkruajeni të plotë!

Erion Braçe - Kështu është: “ Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Anastas Angjeli - Tatimi mbi lojërat e fatit.

Erion Braçe- Më fal! Lexova paragrafin e fundit.

Anastas Angjeli - Çështja e dytë që kam dhe hap diskutim...

Erion Braçe- Në fjalinë parë e keni të pasaktë, mungon fjala “fitim”, tatimi për lojërat e fatit...

Anastas Angjeli - Është teknike. Nuk është “tatim fitimi”. Sqarojeni!

Arben Ahmetaj - Është shumë e saktë. Nuk është tatim- fitimi, ka koncept tjetër. Është një taksim komplet tjetër, i merr bruto. Është diferenca, e shpjegon më vonë.

Anastas Angjeli - Ky është ndryshimi midis paragrafit të parë dhe paragrafit të fundit. Kur keni thënë tatim –fitimi llogaritet sipas dispozitave, këtu flisni për një përcaktim të ri të tatimit mbi të ardhurat bruto.

Arben Ahmetaj- Janë dy taksime të ndryshme. Është shumë e qartë.

Anastas Angjeli - Mbaroi kjo çështje.

Çështja e dytë ka të bëjë me faktin: a do të zbatohet? Kur hyn në fuqi ky nen? Për cilin subjekt zbatohet? Ka fuqi vepruese për subjektet aktuale, të cilat kanë lidhur kontratë dhe e kanë tatimin 10%? Ka efekt apo do t’i detyroni këto subjekte që kanë lidhur kontratën të shkojnë në gjyq dhe të abrogojnë nenin? A mund të na thoni? Supozojmë se Lotaria Kombëtare ka kontratën me 10%, ju nxirrni ligjin sot që do të hyjë në fuqi më 1 janar, ia ndryshon dot këtë kontratë? Kemi të drejtë ne me këtë ligj që t’ua ndryshojmë apo ai ka të drejtë të na atakojë ne apo disa subjekte të tjera? Brenda kësaj pyetje, kjo për cilat shtrihet, për të gjitha llojet e lojërave të fatit, bastet e të tjera? Kur hyn në fuqi?

Arben Ahmetaj – Kjo unifikon konceptin e tatimit. E unifikon dhe jo pa arsye dhe do të ushtrohet mbi të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari në lojërat e fatit pa asnjë dallim. Jemi duke iu referuar ligjit organik “ Për lojërat e fatit”.

Erion Braçe – Zoti Ministër, a nuk krijon konflikt kjo? Kam hallin se mos bllokohet zbatimi i ligji për pikat e tjera.

Arben Ahmetaj – Jo, zero, nuk ka asnjë konflikt.

Erion Braçe- Dakord, ju e dini.

Arben Ahmetaj- Zoti kryetar, kjo shkon me logjikën tuaj dhe të Kryeministrit për të rritur ngarkesën fiskale ndaj lojërave të fatit.

Erion Braçe – Zoti Ministër, edhe një herë që të jemi të qartë, edhe ata që kanë një kontratë do të zbatojnë pikërisht këtë formulim të ligjit?

Arben Ahmetaj - Edhe ata që kanë një kontratë. Do ta unifikojmë. Kemi ligjin organik, i cili ka dalë pas kontratave. Pse do të krijojmë një regjim tjetër fiskal, u ngritën për të gjitha, dikur ka qenë dikur 10, u ngrit për të gjitha u bë 15. Pra, 15 do të jetë për të gjitha. Nuk krijojmë diferenca në korsi. Ne do të zbatojmë ligjin e unifikuar. Nëse do ta godasë, le të vijë ta godasë, praktikisht. Si do të krijojmë ne xhepa brenda sektorëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk bllokohet asnjë nen, sepse jemi duke folur për një kontratë, për një subjekt. Ky nen është nen organik dhe trajton të gjithë sektorin. Ka një kontratë, që ka kaluar në parlament me 10%, ne po e unifikojmë dhe po e bëjmë 15%, edhe mënyrën e llogaritjes meqenëse ka qenë e paqartë, sepse nuk reflektohej njëloj në të dyja, në kontratë dhe në ligj.

Zoti kryetar, nuk shikoj asnjë shqetësim.

Erion Braçe- Zoti Ministër, meqenëse jemi te kjo pikë, kam 2 gjëra për të thënë për punët e lojërave të fatit.

Së pari, KLSH-ja referuar edhe seancës së raportimit të saj ka llogaritur një dëm ekonomik kolosal në sektorin e lojërave të fatit. Ne u informuam këtu se ky dëm i llogaritur, i prezantuar nga KLSH-ja i referohet operacionit të zhvilluar vite më parë dhe faktit që sekuestrimi i çdo makine të lojërave të fatit të palicencuara duhet të ishte shoqëruar edhe me gjobën respektive. Dëmi i prezantuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit arrin në 500 milionë dollarë.

Zoti Ministër, e gjitha kjo u amplifikua këtu si vjedhje, si grabitje, pavarësisht se ato makina janë sekuestruar. Ajo që më shqetëson është se duhet t'i japim një zgjidhje përfundimtare njësimi të çdo veprimi administrativ në raport me lojërat e fatit.

Arben Ahmetaj – Konfiskimi është dënimi maksimal në një sipërmarrje.

Erion Braçe - Dakord.

Zoti Ministër, ju përgjigjeni nga pikëpamja ekzekutive, unë këtu përgjigjem edhe nga pikëpamja politike. Si thatë më parë? Kur të bëheni deputet pa asnjë lloj problemi.

Arben Ahmetaj - Unë jam deputet, jam edhe anëtar i qeverisë, qeveria është krijesë politike.

Erion Braçe – Kur të jeni vetëm deputet.

Arben Ahmetaj- Unë kam qenë edhe vetëm deputet, nuk është kjo logjika.

Erion Braçe - A ka mundësi, unë e kam shumë të vështirë që të duroj këtu një akuzë politike të rreme, të ardhur në vijimësi nga kjo ana që mungon, në raport me këtë çështje. Do të doja të sqarohet deri më një, çdo detaj i pretenduar nga KLSH-ja për këtë çështje.

Në fund të këtij viti mbaron afati. Afati përfundimtar për mbylljen e lojërave elektronike...

Arben Ahmetaj - Nuk shtyhet.

Erion Braçe- Ta mbaroj!

Jam i lumtur që keni këtë vullnet, por duhet të merren masa që ky aktivitet të mbyllet në datën 31 dhjetor të vitit 2018, që do të thotë se të gjitha masat administrative, të gjitha aktet duhen të përpilohen me qëllim që më 1 janar të vitit 2019 lojërat elektronike të fatit të zhduken nga çdo fund pallati, bodrum pallati dhe të dalin atje ku i ka përcaktuar ligji.

Kemi diskutuar edhe bashkërisht për një tatim të ri për kompanitë e basteve apo jo?

Arben Ahmetaj - Sot kemi unifikuar 15% -shin dhe kemi sqaruar konceptin e taksimit të tyre në referencë të diferencës midis të ardhurave bruto dhe shpenzimeve bruto. Brenda Ministrisë së Financave ka një analizë sesi mund të ndryshojë tatimi. Kur të kemi një qartësi do ta ndajmë menjëherë...

Erion Braçe - Këtë kërkesë kam edhe unë, që në momentin që do të paraqiteni këtu me paketën e re fiskale vjetore, pa asnjë lloj diskutimi këtë çështje duhet ta shqyrtojmë. Unë mendoj se kjo çështje duhet të jetë dhe mund të jetë atribut vetëm juaji dhe i parlamentit. Unë nuk besoj në fushata, të mos i vë një epitot tani që në edicione lajmesh flasin 20 minuta kundër lojërave të fatit dhe në të gjitha emisionet që pasojnë kanë reklamë pa fund nga lojërat e fatit. Kjo lloj historie që këtij bëhet presion dhe këtij arkëtohen para duhet të marrë fund këtu me ligj.

Arben Ahmetaj - Dakord.

Erion Braçe - Kalojmë te neni 6, “ Dispozitat kalimtare” që numërohet neni 7.

Neni 2, që ndryshon nenin 20 të ligjit nuk do të zbatohen për kontratat e shkëmbimit, që janë regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ka ndonjë vërejtje? Jo. E hedhim në votim.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 7: “Hyrja në fuqi e ligjit”.

Kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim?

Miratohet!

Përfunduam me këtë ligj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Reme Lala, Xhevit Bushaj dhe Ilir Beqja.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Roland Xhelilaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Agron Shehaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makro-ekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse sektori

Alba Çaroshi – Këshilltare

Arbër Lleshi – Këshilltar

Erion Braçe - Vazhdojmë me ligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”

Zoti Ministër, fare shkurt për ligjin, për sistemin e taksave vendore.

Arben Ahmetaj – Shumë shkurt. Në kuadër të ndryshimeve dhe lehtësimeve fiskale, për ndërtimet e reja në agroturizëm, duke iu referuar të njëjtit definicion, ne kemi përjashtuar nga taksa e infrastrukturës gjithë ndërtimet e reja të agroturizmit. Pra, është pjesë e paketës lehtësuese për agroturizmin. Më pas do të kemi edhe TVSH-në, kështu që po i përmbledh në një. Pastaj, kur të jemi nen për nen, kemi mundësinë që...

Erion Braçe – Në rregull!

Atëherë, zoti Ministër, unë s’kam ndonjë gjë me këtë pikë, por kam një shqetësim që lidhet me të njëjtën taksë, me pagesën e taksës së infrastrukturës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në tërësi, dhe po prapë, e kam specifikisht për fshatin. Për shkak të reformës administrative, tashmë bashkitë e mëdha kanë përfshirë brenda tyre edhe zonat rurale. Ajo që ne vërejmë nga zbatimi i legjislacionit, është se ka një diferencë midis bashkive të ndryshme në lidhje me interpretimin e ligjit, veçanërisht sa i takon taksës së infrastrukturës.

Ligji thotë se, në rast se aplikon një shoqëri ndërtimi për leje ndërtimi, për të ndërtuar në zona rurale e të tjera me radhë, tatimi është 4 %. Në rast se aplikon për ndërtime të tjera, të paktën kështu e kupton një pjesë e njësive administrative, një pjesë e njësive vendore; pra, në rast se aplikojnë vetë familjarët, pra kur investitor është bujku, fermeri, ai që banon në zonën rurale, tatimi është nga 1 % deri në 3 %.

Aplikimi i normës prej 4 % të taksës së ndërtesës ka krijuar një problem shumë të madh në fshatrat që janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taksën e infrastrukturës, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, taksën e infrastrukturës.

Ka krijuar një problem shumë të madh, sepse 4 % e vlerës së investimit në ndërtesë, është një vlerë e konsiderueshme, gjë e cila ka sjellë ose ndalimin e ndërtimeve në fshat ose vijimin e ndërtimeve informale në fshat.

Tani do të duhet të na sqaroni me një akt a me çfarë të doni ju, ose ta sqarojmë këtu, përfundimisht: kush aplikon, si aplikon dhe me çfarë norme takse infrastrukture do të trajtohet? Gjithmonë e kam fjalën për zonat rurale, për fshatin.

Unë e kuptoj se në qytet, pa asnjë lloj diskutimi do ta paguash 4 % taksën e infrastrukturës, por në fshat ka sjellë si pasojë këtë fenomen për të cilin po flasim: ose janë stopuar totalisht, për shkak edhe të veprimit të agjencive ligjzbatuese të shtetit për ndërtime, po ndërtohet informalisht, ose, akoma më keq, po ndodh të merret një leje për rikonstrukcion, ndërkohë që ndërtohet një shtëpi e tërë nga e para.

Tani, që të mos i detyrojmë njerëzit që banojnë në fshat, që të kryejnë akrobaci të tilla, do t'ju lutesha për një sqarim të plotë të kësaj historie, me qëllim që këta njerëz të trajtohen në mënyrë më të drejtë e më të ndershme të mundshme.

Urdhëroni!

Arben Ahmetaj – Dakord! Në këndvështrimin tim është e qartë mënyra se si e ka parashtruar ligji. Kjo në këndvështrimin tim. Megjithatë, ne do t'i bëjmë një analizë gjithë teknikës legjislative dhe shprehjes dhe do të dalim në një konkluzion. Në qoftë se do të ketë nevojë për udhëzim të ri, do të bëjmë një udhëzim të ri. Në qoftë se ka nevojë ta korrigjojmë së bashku këtu, në paketën fiskale të vjeshtës, do ta bëjmë.

Erion Braçe – Domethënë, zoti Ministër, gjithçka lidhet me pikën 2.

Arben Ahmetaj – Jemi të qartë! Jemi shumë të qartë!

Erion Braçe – Shqetësimi im ka të bëjë me faktin që njëra bashki e ka krijuar këtë precedent, dhe të gjitha bashkitë kanë ndjekur shembullin e asaj bashkie.

Arben Ahmetaj – Qartë, qartë, dakord!

Erion Braçe – Tani unë mendoj se kur aplikon një bujk për leje ndërtimi, aplikon një bujk, pra, një banor i asaj zone rurale, që do të ndërtojë shtëpinë. Kështu, ky banori nuk mund të trajtohet si shoqëri ndërtimi, siç është pika 2.

Arben Ahmetaj – Jam shumë i qartë. Praktikisht...

Erion Braçe – Marrëdhënia ime, si banor i asaj zone, që kam aplikuar për leje ndërtimi me një kompani, shoqëri, sh. p. k., ç'të jetë, për të ndërtuar shtëpinë, është çështja ime, nuk është çështja e bashkisë që e jep këtë leje ndërtimi.

Arben Ahmetaj – Gjithsesi, unë e thashë fjalën time, sipas këndvështrimit tim, ndaj do ta mbyll shumë shpejt, por në këndvështrimin tim është shumë e qartë se si është shkruar.

Domethënë pika 2, i referohet rastit të ndërtimit për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit.

Erion Braçe – Po pra!

Arben Ahmetaj – Kjo është shumë e qartë. Shoqëritë e ndërtimit, s'kam nevojë t'i referohem, janë shoqëri, persona fizikë apo juridikë kryesisht, që kanë destinacione, pra e

kanë të përshkruar në QKB ndërtimin, dhe e kanë, dhe e kanë si funksion operacional dhe orientim fitimi të parë, të dytë apo të tretë.

Në rastin e ndërtimeve të ndryshme, në ato të përcaktuara në pikën 2, dhe këtu është shteruese pika 2 e këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1% – deri në 3 % të kësaj vlere, ndërsa për bashkinë e Tiranës është 2 % – 4%, pra ka krijuar një diferencë. Në rastin kur një fermer, siç iu referuat ju, një individ, një familjar që bën një kat shtesë. Pra, e bën vetë, jo me shoqëri ndërtimi, që kanë si objekt,,,

Erion Braçe – Aplikimin e bën vetë.

Arben Ahmetaj – Po.

Erion Braçe – Nesër ai mund ta ndërtojë me...

Arben Ahmetaj – Le ta ndërtojë me kë të dojë ai; për aplikimin po flasim.

Erion Braçe – Këtë po kërkojmë, pra.

Arben Ahmetaj – Nesër ai mund të kontrakttojë një kompani ndërtimi, por aplikimin nuk e ka bërë shoqëria.

Erion Braçe – Po pra, e kam bërë unë.

Arben Ahmetaj – Kjo është e qartë fare. Megjithatë, ne do ta analizojmë edhe një herë me veten tonë dhe do të reflektojmë shumë kollaj. Mund të shtojmë në udhëzim ekzaktësisht fjalën “aplikimi” ose, nëse nuk do të jetë mund të kërkojmë një ndryshim në vjeshtë.

Erion Braçe – Në rregull!

Arben Ahmetaj – Dakord!

Erion Braçe – Zoti Beqaj ka diçka.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Së pari, zoti Ministër, unë do të kërkoja vëmendjen tuaj, që në paketën e vjeshtës të mund të shikoni trajtimin e një çështjeje, që në komisionin tonë të Veprimtarive Prodhues na ka ardhur nga operatorët që ofrojnë shërbimin e internetit në qytete të ndryshme.

Nga këshilli bashkiak i Beratit, i është dhënë një kompanie fondi për të shtruar kabllon e internetit, por kjo kompani ka vendosur tarifa jashtëzakonisht të larta, saqë praktikisht, shërbimi i internetit në Berat, në këtë formë, kushton minimalisht 60-70 mijë lekë të vjetra në muaj. Një tarifë e tillë kthehet pastaj në barrierë për përhapjen e internetit. Në qoftë se kur të vini në tetor, nëntor, mund ta trajtoni këtë çështje...

Arben Ahmetaj – Zoti Beqaj, më fal! Të falënderoj për pyetjen dhe do të jap një përgjigje. Nëse e trajtojnë si tarifë janë duke shkelur ligjin e financave të pushtetit vendor, sepse aty e kemi të definuar se çfarë tarifash mund të vendosë pushteti vendor. Në qoftë se e

trajtojnë si taksë infrastrukture, është përsëri gabim, sepse ne e kemi sqaruar këtë gjë, ndaj nuk është normale që për kablo të ushtrosh taksë infrastrukture.

Megjithatë, është me vend ajo që ju kërkoni. Ne po e mbajmë shënim dhe po reflektojmë, sepse pastaj bëhet kakofoni fiskale gjithandej.

Ilir Beqaj – Përveç kësaj, ju lutem, ndoshta një shpjegim me prefektët, të cilët kanë për detyrë të miratojnë aktet e këshillave, që ta kenë edhe ata në vëmendje. Faleminderit!

Çështja e dytë: në nenin 10 të ligjit aktual, thuhet: “Çdo subjekt që kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, qarkullimi më i vogël ose i barabartë me 8 milionë lekë, i nënshtrohet këtij lloj tatimi”.

Tashti unë filloj me pyetjen: në momentin kur ligji i mëparshëm, më 1 janar të vitit 2019 do të hyjë në fuqi, ai i tatimit mbi të ardhurat, dhe një subjekt do të ushtrojë një xhiro prej 10 milionësh, do të rrijë këtu apo do të shkojë atje?

Arben Ahmetaj – Është shumë e qartë se do të shkojë atje. Ky është tatim-fitim i thjeshtësuar, ndërsa ai është tatim-fitimi.

Ilir Beqaj – Nëse shkon atje, edhe pse mund ta ketë formën “person fizik”, mbas tatim-fitimit, a i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat nga dividendi?

Arben Ahmetaj – Po ne e kemi sqaruar këtu. Pra, e kemi anuluar, e kemi hequr personin fizik në një nga nenet, sepse personi fizik nuk ka dividend.

Ilir Beqaj – Atëherë krijojmë një regjim atje, me këtë që miratuam sot, që një sh. p. k. me 11 milionë lekë të reja xhiro ka 5 % tatim dhe dividend, ndërsa një person fizik me 11 milionë lekë të reja xhiro ka vetëm 5 % dhe s’ka dividend, e ndoshta vetëm nga forma juridike e organizimit të aktivitetit ekonomik krijojmë prapë arbitrazh fiskal.

Arben Ahmetaj – Po.

Ilir Beqaj – E keni pranuar që të jemi arbitrazh fiskal?

Arben Ahmetaj – Po.

Ilir Beqaj – Dakord! Atëherë, komenti tjetër që kam, është ky: praktikisht, ne kemi 8-milionëshin, të vendosur që prej 2006-ës, ndërsa nga 2015-a kemi edhe 5-milionëshin. Vlerësimi 8 milionë në 2006-ën ka qenë në kontekstin ekonomik të asaj kohe. Unë mendoj se ka ardhur momenti, që këto dy pragje të kenë korrelacion me njëri-tjetrin, e ndoshta do të ishte mirë të koeficientoheshin. Koeficientët ndjekin logjikën e zhvillimit ekonomik, dhe ju çdo vit, me buxhetin vjetor dhe me paketën fiskale, rivlerësoni, kryesisht në bazën e vlerësimeve të INSTAT-it vlerën e koeficientit dhe, automatikisht, i gjithë legjislacioni harmonizohet. Kur kemi vlerësuar 8 milionë në 2006-ën, i bie një xhiro ditore 230 mijë lekë. Xhiroja ditore sot ka shkuar 300 mijë vetvetiu. Mbas pesë vjetësh mund të shkojë 400 mijë.

Vetëm me ndonjë normalitet nga 8inflacioni, nga rritjet e kostove e të tjera, praktikisht nga i vogël bëhesh i madh, por jo se u rrite.

Unë besoj se po ajo logjikë e drejtë, që ju, në reflektim të kërkesës së komisionit e kryeministrit, për të vlerësuar pragun 10 – 11, shkuat te 14-a, po kjo logjikë duhet të vlejë për të rritur pak edhe 5-ën. Ndoshta edhe 2-shin, por aty na komplikon TVSH-në, ndaj më mirë të konsolidojmë TVSH-në. Atë të mos e prekim.

Unë vlerësoj se është momenti që, me të njëjtën logjikë harmonike, edhe 5-a duhet rivlerësuar për nga lart.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Juve e keni përdorur indeksimin në katër vjetët e fundit dhe e keni çuar te 6-a, ne po bëjmë një analizë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

10 % maksimumi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord! Ne po bëjmë një analizë, se edhe definicioni i biznesit të vogël mund të ketë nevojë për t'u rishikuar edhe me aktet e biznesit të vogël europian, se si i ndryshojnë ndërvite. Shumë vende nuk i kanë ndryshuar, por i kanë lënë të definuara, megjithëse inflacionin e kanë 1 %, 1, 5 %.

Gjithsesi, ne do ta shohim, do të reflektojmë. Nëse do të ketë nevojë të bëjmë ndryshime, do të bëjmë ndryshime. Nëse s'ka nevojë, gjithsesi do të ndajmë me ju analizën.

Faleminderit!

Erion Braçe – Në rregull!

Te ky ligj kemi një formulim, Niko, apo jo? A keni bërë një riformulim këtu?

Nikolla Lera – Jo, s' kemi riformulim.

Arben Ahmetaj – Çfarë riformulimi kemi bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull! Qartë!

Erion Braçe – Kjo e zëvendëson komplet nenin? Kjo këtu? Në rregull!

Atëherë, riformulimi me qëllim unifikimin e terminologjisë është ky: “Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse, të certifikuara si agroturizëm, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.”

Dakord? E hedhim në votë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, urdhëro!

Arben Ahmetaj – Kryetar, investimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë ta saktësojmë, pra.

Atëherë, e hedhim në votim nenin 1, me ndryshimin respektiv?

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 2. Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për sistemin e taksave vendore, të ndryshuar”.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Reme Lala, Xhevit Bushaj dhe Ilir Beqja.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Roland Xhelilaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Agron Shehaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makro-ekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit

Enkeleda Kuçi (Bako) – Përgjegjëse sektori

Alba Çaroshi – Këshilltare

Arbër Lleshi – Këshilltar

Erion Braçe - Kalojmë te ligji tjetër: “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Zoti Ministër, a doni ta shpjegoni këtë ndryshim që keni sjellë tek tatimi mbi vlerën e shtuar?

Arben Ahmetaj – Shumë shkurt. Në logjikën e gjithë paketës për të lehtësuar sipërmarrjen, kryesisht të vogël, të turizmit, por gjithashtu edhe të bujqësisë, ne po i referohemi ndryshimit të shkallës së TVSH-së me një shkallë të reduktuar për agroturizmin, në bazë të definicionit që iu referuam, por edhe gjatë diskutimit më parë, Dua të jem shumë i qartë në këtë reduktim shkalle. Bëhet fjalë vetëm për akomodimin, mallrat dhe ushqimin. Mallrat e akcizës nuk janë mallra që duhen reduktuar. Është gabim fiskal dhe nuk shkon në favor të konsumatorit. Kjo është e provuar. Kështu, ta përcaktojmë mirë këtë vijë, sepse ju, së bashku me mua, jeni gardianë të sistemit fiskal. Është e shëndetshme të bëjmë reduktimin e TVSH-së, ta lehtësojmë te akomodimi dhe ushqimi, të provojmë me ushqime bio, me çmim më të lirë, që reduktimi të kalojë te konsumatori. Gjithsesi, duke iu referuar edhe traditës në turizëm, nuk është se e gjitha kaloi te konsumatori, por, sigurisht, logjikën fiskale e kemi të shëndetshme. Kështu, besoj se po sjellim një lehtësim të rëndësishëm, duke ofruar dy korsi kryesore të fitueshmërisë e të produktivitetit të agroturizmit: akomodimi dhe ushqimi bio. Këto të dyja përbëjnë agroturizmin në themel. Dhe qumështi nuk është pije, qumështi është ushqim, pra nuk është pije e akcizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe - Ju lutem, me radhë! Të mbarojë ministri një herë.

Arben Ahmetaj - Unë mbarova. Besoj se me këtë paketë kemi plotësuar një premtim elektoral të Kryeministrit, të Partisë Socialiste, të qeverisë, maxhorancës dhe tuajin, zoti kryetar.

Besoj se detyra jonë tashmë është që, pasi kemi ofruar kaq lehtësi të mëdha, ku gati 91% të bizneseve u kemi ulur barrën fiskale, do të duhet të jemi gardianë shumë të vëmendshëm të sistemit fiskal.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Ministër, mua më vjen shumë mirë nisur edhe nga përmbyllja që bëtë, pa asnjë lloj diskutimi që ju do të keni mbështetjen tonë të padiskutueshme për ta bërë rolin e gardianit deri në fund, por ne nuk e kemi mbyllur ende këtë pikën këtu. Nga kongresi kemi edhe dy pika të tjera, por po flasim për këtë pikën këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, pa asnjë lloj problemi, por nga kongresi që kemi bërë para zgjedhjeve, kemi edhe dy pika të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, tri mandate, kemi edhe tre vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shikoni, zoti Ministër, ju e dini që unë trembem nga zoti Basha! Kështu që unë dua ta arrij shtatorin para se zoti Basha t'i vërë zjarrin Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, kemi edhe dy pika të shënuara nga kongresi, ndërkohë që te ky nen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa asnjë lloj diskutimi që mua më pëlqejnë argumentet tua, i dëgjoj me shumë vëmendje vazhdimisht.

Ju e thatë me të vërtetë atë parimin se pijet e akcizueshme nuk duhet të përfshihen në shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, por në një rast të ngjashëm i kemi përjashtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Madje atje kemi përjashtuar edhe pijet e akcizueshme të importit, ndërkohë që shqetësimi i ngritur këtu, me plot të drejtë, nga relatorja e komisionit, zonja Kushi, lidhet thjesht dhe vetëm me produktin e prodhuar brenda njësisë së klasifikuar si agroturizëm, që shitet vetëm brenda njësisë dhe konsumohet brenda njësisë së certifikuar si agroturizëm.

Më specifikisht, ju e dini që unë jam fillospanjoll e të tjerë me radhë, jo më larg se dje kam parë strukturën e agroturizmit, atë të emërtuar *Bottega Iniesta*.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e atij futbollistit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, patjetër.

Në rast se marrim atë model, unë po ju them se të gjitha strukturat që sot funksionojnë si agroturizëm, pa e marrë ende certifikimin, për shkak të nevojave të ligjit e të tjera me radhë, në qarkun e Beratit i bie të mos përfitojnë. Pse? Njëzet hektarë, tridhjetë hektarë, një fshat i tërë, siç është Rroshniku (me vreshta), për shkak të vreshtave është ndërtuar atje një kantinë, më pas janë ndërtuar edhe disa dhoma. Sot që flasim, Berati është plot me turistë që e vizitojnë Beratin, sepse është përfshirë në guidën turistike, që nuk do ta përfitojë statusin agroturizëm për një arsye të thjeshtë, sepse ajo është një kantinë.

Tani, unë dua ta ndaj aktivitetin e kantinës së verës, së rakisë e të tjerë me radhë, të prodhuar aty, nga aktiviteti që ky do të ofrojë si strukturë agroturizmi.

Në qoftë se ne përjashtojmë për këtë rast pijet e prodhuara nga vetë struktura, të shitura brenda strukturës dhe të konsumuara vetëm brenda strukturës, në qoftë se unë do të dal atje matanë, do të marr një arkë me vete për të ikur, për ta çuar, ku ta di unë, në çdo cep të Shqipërisë apo do të paguaj akcizë apo tatim mbi vlerën e shtuar, qindarkë më qindarkë, dhe as nuk e diskutoj këtë, por të konsumuar brenda njësisë, unë mendoj se duhet të jetë furnizim i përjashtuar ose furnizim me 6%, jo i përjashtuar. Pra, njësoj siç e kemi bërë...

Arben Ahmetaj – Zoti kryetar...

Erion Braçe – ...këtë vlerësim për hotelet.

Arben Ahmetaj – ...unë nuk bie dakord me ju për dy arsye.

E para, sepse për nga struktura dhe administrata është e pamundur që agroturizmi të kontrollohet njëllë si në strukturën akomoduese me pesë yje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse agroturizmi është poroz në logjikën fiskale, ndërsa strukturat akomoduese me katër dhe pesë yje janë shumë më të kontrolluara në aspektin e territorit fiskal.

E dyta, unë jam kundër dhe do të qëndroj kundër që mallrat e akcizës, pavarësisht se çfarë ka ndodhur në të kaluarën, të promovohen me reduktim të TVSH-së. Fakti se reduktojmë pijet alkoolike të prodhuara, nuk ka pikë rëndësie, të cilët janë akcizueshme me TVSH të reduktuar, nuk është pozitive; nuk kontrollohet dot; nuk transferohet te konsumatori.

Për sa i përket akomodimit dhe ushqimit, janë dy korsi shumë të shëndosha. Kështu që, unë ju kërkoj ndjesë në këmbënguljen time, madje ju ftoj të mos e cenojmë rrjetën e fortë fiskale të mallrave të akcizës dhe të TVSH-së, pasi janë dy taksa, janë dy të ardhura, burime të cilat shëndoshin buxhetin e shtetit!

Po jua kërkoj edhe si ministër, edhe si deputet, edhe si një nga ju, që kemi bërë bashkë programin e qeverisë, të mos e cenojmë shëndetshmërinë fiskale me propozime legjitime diku emocionale, për shkak të origjinës politike prej nga vijmë, diku për shkak edhe të mendimit ekonomik, sepse, më besoni, e cenojmë shëndetshmërinë fiskale.

Jemi mirë? Le ta shohim si do të na funksionojë kjo. Këtu do të jemi sërish dhe vijmë prapë, ulemi dhe diskutojmë.

Pra, jemi duke bërë një hap të parë në mbështetje të agroturizmit. Le të shohim si na funksionon definicioni, se edhe definicioni duhet parë se si do të funksionojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe duhet centruar, pra, në këndvështrimin tim, duhet bërë edhe më i qartë.

E dyta, le të shohim si do të na funksionojë ecuria e licencimeve dhe e certifikimeve.

E treta, le të shohim si do të na funksionojë ndërtimi, sepse i kemi dhënë ndryshe nga të gjithë të tjerët taksën e infrastrukturës, investimet e reja.

Pastaj, e katërta, le të shohim si do të na funksionojë akomodimi dhe ushqimi, si do të lulëzojë ushqimi bio, që e kemi si qëllim.

Më tutje do të mendojmë përtej qumështit, do të mendojmë për alkoolin.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Ministër, unë besoj se ju e dini që vera nuk është alkool.

Arben Ahmetaj – Vera është pije alkoolike.

Erion Braçe – Po, mirë, shumë mirë.

Tani, mua më pëlqen vendosmëria juaj. E marr të mirëqenë edhe argumentin tuaj që bëhet e vështirë, sepse struktura është poroze e, ku ta di unë, të tjera me radhë, por këtu kemi vendosur disa rregulla për kontrollin: “Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6%, është personi i regjistruar me NIPT më vete, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si agroturizëm”.

Arben Ahmetaj – Nuk jam dakord dhe kam argumentet e mia. Do t’ju bëja thirrje të mos...

Erion Braçe – A ka mundësi ta mbaroj unë?

Arben Ahmetaj – ...cenonit sistemin fiskal.

Erion Braçe – Patjetër.

Arben Ahmetaj – Nuk është e shëndetshme!

Erion Braçe – Por ky është mendimi juaj, pa asnjë lloj diskutimi.

Arben Ahmetaj – Kemi mendime të ndryshme.

Erion Braçe – Tani, unë e kam të ndaluar ta them?

Arben Ahmetaj – Jo, more jo, më vjen keq! Unë po shpreh qëndrimin tim.

Erion Braçe – Më lejo tani të flas!

Arben Ahmetaj – Unë po them se, në mënyrë absolute, nuk duhet çarë rrjeta fiskale.

Erion Braçe – Zoti Ministër...

Arben Ahmetaj – Po ofrojmë lehtësi fiskale ekstreme dhe kemi bërë shumë mirë për këta sektorë. Në mënyrë absolute nuk duhet prekur rrjeta fiskale.

Erion Braçe – Zoti Ministër, nuk e kemi miratuar ende.

Me qetësi!

Arben Ahmetaj – Si?

Erion Braçe – Nuk e kemi miratuar.

Mos u ekstremizoni kaq shumë!

Arben Ahmetaj – Unë jam pasionant edhe për punën që bëj, por unë kam shqetësimin, sepse, në modestinë time, këtë sektor e njoh prej vitesh dhe çdo...

Erion Braçe – Dakord.

Arben Ahmetaj – ...shthurje sjell shthurjen e trikos së madhe.

Erion Braçe – Patjetër, nuk e diskutoj fare që ju e njihni këtë sektor më mirë se sa unë.

Arben Ahmetaj – Nuk jemi në garë me askënd, përkundrazi...

Erion Braçe – Jo, jo, por meqenëse e thatë. Jua njoh këtë meritë, po, e njihni shumë më mirë se unë.

Arben Ahmetaj – Nuk jemi në garë.

Erion Braçe – E para, keni vendosur këtë në ligj.

E dyta, unë shikoj thuajse çdo javë se punonjësit e përkushtuar të Tatimeve, që janë strukturë më strukturë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë strukturë më strukturë, në hotele, në restorante, në tavolina; janë kudo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë thuajse çdo fundjavë dhe e bëjnë detyrën me një përkushtim shembullor, me thënë të drejtën, kontrollojnë çdo faturë. Rrinë aty në tavolinë derisa ai të sjellë faturat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, si nuk paskeni ju mundësi ta kontrolloni?

Arben Ahmetaj – Jo, nuk jemi në gjendje!

Është strukturë poroze, gjë që e ka treguar historia fiskale.

Erion Braçe – Pse qenka poroze 1 kilometër larg nga bregu, ndërsa në breg nuk qenka poroze?

Arben Ahmetaj – Janë poroze për shkak të natyrës fiskale.

Unë kam për detyrë të qëndroj rigoroz ndaj ruajtjes së sistemit, ndërsa ju, si përfaqësues i një force politike, së bashku me mua, keni për detyrë të avanconi, gjithashtu bashkë me mua, projektin tonë fiskal, gjithashtu, të rritjes ekonomike. Por këtu...

Erion Braçe – Mos na caktoni edhe detyrat tani.

Arben Ahmetaj – ...më besoni, jemi në një hap të parë të lehtësimit dhe unë nuk bie dakord.

Juve jeni deputet, jeni ligjvënës dhe mund të bëni çfarë të doni, por unë ju bëj thirrje si ministër, si deputet, si anëtar i të njëjtit grup parlamentar se, ditën që cenojmë rrjetën fiskale, kemi hapur kutinë e Pandorës në këtë nënsektor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam shumë i vendosur që mos ta bëjmë.

Gjykimi për ta votuar ose jo është juaji. Unë do të ngelem dhe do ta votoj kundër, që të ulim pijet alkoolike në një strukturë poroze nga 20% në 6%. Madje, jam i bindur se në këto produkte ulja nuk shkon te konsumatori. Jam i bindur për këtë!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Patjetër, ju mezi po prisnit.

Ervin Bushati – A mund të kemi shembuj analogë se si ndodh në shtete të tjera që e kanë zbatuar këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Jo, jo, zoti Ministër, po bëjmë politikë me një sektor të tërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me një sektor të tërë që, me mish e me shpirt të atyre njerëzve, është rikthyer dhe mendohet të vijë të realizohet në Shqipëri.

Si ishte pyetja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ka qenë një diskutim i gjatë dhe i gjerë që e kemi nisur që para disa muajsh apo gati një viti e gjysmë. Dua të di, në vendet analoge si është zbatuar, për shembull, në Itali, në Greqi, që e kanë agroturizmin? Si janë rastet? Pastaj ne mund të gjykojmë. Kërkojmë ndihmë nga të dyja palët.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë pra, mirë. Nga ju që jeni kundër dhe nga ky, që është pro, mor burrë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam një njeri që dua të gjykoj mbi shifra dhe argumente.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e ka Italia, Greqia, Sllovenia, Kroacia? Raste të ngjashme.

Erion Braçe – Po më pyesni mua?

Ervin Bushati – Të dyja palët.

Erion Braçe – Të dyja palët? Dakord.

Urdhëroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Sipas palëve, i bie që ai të jetë palë e tretë.

Erion Braçe – Patjetër, ashtu është ai gjithmonë.

Arben Ahmetaj – E drejtë, ashtu është ai, palë e tretë.

Ervin Bushati – Doni të bëni shaka? Boll, se nuk po shkon në asnjë vend ky muhabet. Në qoftë se do të dëgjonim si është në vende të ngjashme, do të ishte...

(Deputetët flasin njëkohësisht.)

Erion Braçe – Edhe unë kam një përgjigje. Pa merak.

Ervin Bushati – Që të dy keni argumentet tuaja. Pjesa që mua më pëlqen më shumë fshati, ty nuk të pëlqen dhe kjo na prish punë, mua nuk më duket... Thjesht dua të di si është në vendet e tjera.

Erion Braçe – Të gjithë nga fshati jemi, pa merak.

Arben Ahmetaj – Ka vende që i favorizojnë pijet...

Erion Braçe – Ëëë.

Arben Ahmetaj – ...ka vende që nuk i favorizojnë; ka vende që e lidhin favorizimin e pijeve me 70% prodhim bio të fermës. Pra, ka vende që i kanë ndryshe-ndryshe. Por kjo varet, së pari, nga shkalla e zhvillimit ekonomik; së dyti, nga shkalla e zhvillimit të sektorit; së treti, nga shkalla e rigorozitetit të administrimit fiskal. Për të tria këto aspekte unë mund të sillja dhjetëra shembuj në njëërën anë, që nuk e lejojnë, dhe dhjetëra shembuj, në anën tjetër, që e lejojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Madje mund të sjell edhe shembuj të disekuilibrit për shkak të TVSH-së së reduktuar, por unë do të qëndroj te logjika ime, që e ndava me ju edhe zyrtarisht, edhe profesionalisht.

Erion Braçe – Atëherë, zoti Bushati, besoj se sqarimi i ministrit është shumë i qartë, madje më të qartë po e bëj edhe unë në pozicionin tim.

Tani, unë mendoj...

Ervin Bushati – Në shifra.

Erion Braçe – A më pyete, vëlla?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, unë mendoj se është anormalitet, që një verë e prodhuar në Rroshnik të shitet brenda hotelit me katër-pesë yje në Tiranë e gjetkë me 6% të TVSH-së, ndërkohë që një verë e prodhuar në Rroshnik të shitet në kantinën e Rroshnikut me 20%. Unë e quaj anormalitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu mendoj unë.

Në qoftë se ky është normalitet... Atëherë, mua nuk më rezulton të jetë normalitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dyta, është e vërtetë ajo që thotë ministri, se ka vende që aplikojnë tarifë të reduktuar. Urdhëroni, është Austria, që e bën këtë gjë për prodhimin e verërave brenda një ferme bujqësore të veten.

Pra, për qëllime të zbatimit të nenit 118 të direktivës, Austria mund të aplikojë një normë të reduktuar për verërat e prodhuara në një fermë bujqësore nga prodhues fermerë, me kusht që shkalla nuk është më e ulët se 12%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, Austria është një rast, meqenëse ti je gjermandashës.

Ervin Bushati – Këtu të gjithë, o vëlla!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Jo, sidoqoftë, unë gjykoj se shprehja “me përjashtim të furnizimit të pijeve” ka nevojë për saktësi. Nuk e di kush do ta zbatojë, por kjo pije...

Përderisa ka mallra të akcizës, mund të jetë kështu saktësimi, se kafeja hyn si kokërr, hyn si mall, por për kafënë si do t’ia bëjmë? Pra, mendoj se për sa i përket kësaj shprehjeje, përveç diskutimeve të përgjithshme, ajo që unë shoh si rrezik është se këto janë subjekte goxha në fazë fillestare dhe, duke i detyruar ato ta mbajnë TVSH-në në disa nivele, kam përshtypjen se do t’i ngatërrojmë më shumë. Do t’u bëhet jeta aq e komplikuar, sa të paktën nga eksperiencia ime në të gjithë luginën e Valbonës, ku ka pasur zhvillim pa qenë nevoja për këto lehtësira, një gjë të thonë: “Deklojmë tri herë, ngatërrohem me deklarimin. Na e bëni sa më të thjeshtë gjënë e deklarimit”. T’i mbajnë ato subjekte që janë krejt të reja, të zbatohen nga njerëz që jetojnë atje dhe t’u vëmë disa shkallë, druhen se do t’ua komplikojmë edhe më shumë jetën dhe do t’i bëjmë më vulnerabël ndaj çdo lloj kontrolli që, me të drejtë, kur t’i gjejë në mospërputhje, do të duhet të zbatojë legjislacionin, sepse për atë paguhet.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ka ndonjë mendim apo sqarim tjetër?

Po, urdhëroni, zoti Bushati, urdhëroni!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Nisur edhe nga fakti se ne nuk kemi pasur diskutime normale edhe prej opozitës, si dhe që ky është ligj shumë i rëndësishëm, që do t’i japë shumë shtysë agroturizmit, pas një diskutimi të gjatë, që kemi bërë dhe meqenëse argumentet janë pro dhe kundër, unë do të doja të kishim edhe një material të shkruar për ta argumentuar edhe më mirë, si dhe t’i japim vetes

edhe pak më shumë kohë për këtë pjesë, pasi më duket se është e rëndësishme. Pra, të merrim edhe nga komisioni, stafi, edhe nga ministria dhe të shikonim si është në vendet e tjera, si janë argumentet pro dhe kundër, e të vendosim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Kjo nuk ka lidhje se si është në vendet e tjera, sepse unë jua solla shembullin. Problemi këtu është që ka një qëndrim shumë të qartë, unë e mirëkuptoj pa asnjë lloj diskutimi, sepse administrimi fiskal është një nga elementet kyçe dhe më të rëndësishme që kjo qeveri, kjo maxhorancë e ka përballë si sfidë, diferenca bëhet ekzaktësisht këtu, ndërkohë që ditën e hënë është seanca plenare kur do të votohet kjo gjë.

Tani, për ta mbyllur, se unë e shikoj që nuk ka mirëkuptim, votojmë variantin e qeverisë, ndërkohë që unë, në qoftë se bashkohet edhe zonja Kushi...

Evis Kushi – Po.

Erion Braçe – ...do të paraqes amendime në seancë plenare.

Ndërkohë, zoti Niko, na duhet të saktësojmë çështjen se çfarë konsiderohet pije, sepse ka të drejtë zonja Gjylameti kur thotë se lëngu i thanës nuk është pije, është lëng; qumështi...

(Ministri Ahmetaj flet pa mikrofon.)

Nuk thuhet “pije alkoolike” këtu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë pra, por duhet definuar, sepse, dakord, kemi miratuar tri festa rakie me festat e tjera me radhë, ndërkohë që tani iku rakia, u taksua me 20%.

Problemi është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ju lutem!

Të paktën të mos cenojmë pjesët e tjera, që janë pjesë të produkteve të prodhimit të asaj strukture agroturistike, asaj ferme e të tjera me radhë. Kështu që na duhet një definim i qartë i kësaj.

(Ministri flet pa mikrofon.)

Atëherë, për të unifikuar vërejtjen që ka ngritur zoti Beqaj, do të doja të saktësoja formulimin e pikës 4 të nenit 49, që i shtohet projektligjit: “Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6% për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe të restorantit, me përjashtim të pijeve...”, pra ju duhet ta saktësoni se çfarë konsiderohet pije, “...personi i tatueshëm që aplikon shkallën e reduktuar të

tatimit mbi vlerën e shtuar 6% është personi i regjistruar me NIPT/NUIS vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar në agroturizëm”.

E hedhim në votë, që të mos vonohemi më.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Siç ju thashë, edhe një herë, propozimin tim bashkë me zonjën Kushi do t’ia paraqesim seancës plenare për votim.

Në përfundim të shqyrtimit të këtyre tri projektligjeve, dua që të falënderoj, pa asnjë lloj diskutimi, zonjën Gjylameti, zonjën Kushi dhe zotin Bushati, të cilët u morën specifikisht me çështjen e agroturizmit, si dhe të gjithë kolegët e Komisionit të Ekonomisë, përfshirë edhe zotin Xhelilaj, që nuk është këtu, i cili mbështeti punën e kolegëve!

Gjithashtu, dua të falënderoj, pa asnjë lloj diskutimi, ministrin e Financave, që ndodhet këtu dhe u tregua i gatshëm të diskutojë, madje të ofrojë edhe ndihmë për të analizuar të gjithë situatën në këtë sektor, me qëllim që të bënim gjënë e duhur!

Në fund, nuk më mbetet gjë tjetër veçse të theksoj faktin se ky është rasti kur një qeveri dëgjon. Një qeveri që dëgjon, është gjithnjë një qeveri më afër shqetësimeve jo vetëm të sipërmarrjes, por edhe të njerëzve që duan të zhvillojnë aktivitetin e tyre apo resurset e tyre.

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA